



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

Kamëz, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim Vendorsje Kamerash në Hapsirat Publike të  
Bashkisë Kamëz”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kamera  
sigurie 35125300-2,**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 20,833,334 (Njzet milion e teteqind e tridhjetë etre mijë e treqind  
e tridhjetë e kater) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kamez ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për këtë procedurë prokurimi, bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me urdhër nr.9384 datë 14.10.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivin për tenderin.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

1- Sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perفشirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor per të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 2 vitet e fundit financiare (2020 - 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet.

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet. *(Në raste se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që ka shlyer të gjitha taksat dhe tarifat vendore leshuar gjatë vitit 2021, për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të cilat duhet të paraqesi një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin sipas përcaktimeve të Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST dhe bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

**Argumentimi:** Janë kërkuar këto kritere në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të ulët se 40 % të vlerës së fondit limit. Si dëshmi për pervojën e mëparshme kërkohen:

- a) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  
Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,  
nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

---

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ushtron aktivitetin tregtar në fushën objekt prokurimi duke zbatuar normat e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Për këtë kriter ofertuesi duhet të para:

- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 39001:2012 per sistemet e menaxhimit te sigurise rrugore ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 45001:2018 per Sistemet e Manaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne vendet e punes ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit SSH ISO/IEC 20000-1:2018 Teknologji Informacioni - Menaxhimi i shërbimit - Pjesa 1: Kërkesat e sistemit të menaxhimit të shërbimit, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit ISO 14001:2015, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit SSH EN ISO/IEC 27001:2017 Teknologjia e informacionit - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit - Kërkesat (ISO / IEC 27001: 2013, duke përfshirë Cor 1: 2014 dhe Cor 2: 2015), ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 50001:2011 per sistemet e menaxhimit te energjise.

*Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë keto certifikata ne perputhje me zerat qe ka marre persiper te kryeje.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u nisur nga kërkesat e cilësisë së mallrave që do të furnizohen si dhe punimet komplekse që duhet të kryhen për të cilat duhet të jepet garanci. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Vendosja e ketyre certifikatave është kryer pas konsultimit dhe bazuar në Katalogun e Standarteve Shqiptare për vitin 2021.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës së artikujve sipas tabelës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të përcaktojë periudhen e vlefshmerise se tij.

<b>Përshkrimi i Produkteve</b>
Video Regjistrator Rrjeti NVR/Server minimumi 64 Kanale
Kamera IP Bullet te jashteme
Kamera IP Bullet per Lexim Targa dhe Survejim
Kamera IP Bullet per Lexim Targa
Sëitch Rrjeti UPS 8 Port PoE
Sëitch Qendror Fiber 16 Port SFP + 8 Port GB Rrjeti
UPS Qendror
Video Eall

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin 40, pika 5/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë prodhues ose kanë mundësinë të marrin artikujt e ofruar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Gjithashtu nëpërmjet këtij kriteri operatorët ekonomikë dëshmojnë se ofrojnë një produkt cilesor në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Ky kriter është i gërshtetuar edhe me kriteret e tjera të kësaj procedure për furnizimin me mallra cilësore që do të shërbejnë për rritjen e sigurisë publike gjatë vitit 2022, por sidomos gjatë sezonit turistik.

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën sipas pikës 2.3.3, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dorëzojnë ose fragmente të katalogut/ëve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi për të treguar se janë në përputhje me specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, duhet te paraqese mostra te produkteve sipas listes se meposhtme:

<b>Përshkrimi i Produkteve</b>
Video Regjistrator Rrjeti NVR/Server minimumi 64 Kanale
Kamera IP Bullet te jashteme
Kamera IP Bullet per Lexim Targa dhe Survejim
Kamera IP Bullet per Lexim Targa
Sëitch Rrjeti UPS 8 Port PoE
Sëitch Qendror Fiber 16 Port SFP + 8 Port GB Rrjeti
UPS Qendror
Video Ëall

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Nga Autoriteti Kontraktor janë për zgjedhur që të kërkohen mostra për ato mallra që kanë konsum/përdorim më të përgjithshëm, që kanë premisa të dëmtohen/digjen më shpejt dhe që nevoja për to është në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme.

2.3.6 Operatori ekonomik do te paraqese nje deklarate te garancise me afat 1 vit per pajisjet objekt te kesaj procedure prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik do te paraqese nje deklarate qe pas kryerjes se instalimit te pajisjeve dhe konfigurimit te tyre, do te riparoje defektet e mundshme gjate periudhes se garancise brenda afateve te percaktuara ne kontrate, si dhe merr persiper te realizoje te pakten 5 seanca trajnimi te ndryshme me stafin qe do te perdore pajisjet objekt te kesaj procedure prokurimi.

2.3.8 Duke patur parasysh produktet, sherbimet dhe konfigurimet qe duhet te kryhen ne kohe dhe me cilesi per kete procedure si dhe ne funksion te realizimit te pikes 2.3.7 dhe 2.3.8, Operatori ekonomik duhet te disponoje minimalisht stafin e meposhtem te nevojshem ne minimumi 3 muajt e fundit qe duhet te jete i perbere te pakten nga:

- a. Minimumi 2 (dy) inxhinier elektronik/kompjuterik.
- b. Minimumi 2 (dy) inxhinier informatike
- c. Minimumi 1 (nje) inxhinier telekomunikacioni
- d. Minimumi 2 (dy) inxhinier elektrik prej te cileve te pakten 1 (nje) te specializuar per automatizim dhe te licensuar sipas kategorive profesionale per projektet e linjave te rrjeteve elektrike dhe sinjalistikes.
- e. Minimumi 1 (nje) inxhinier ndertimi specializuar per infrastrukture per ndjekjen e punimeve civile te nevojshme per shtrimin e rrjetit fiber optike te licensuar sipas kategorive profesionale per projektet ne rruget lokale, urbane dhe interurbane duke perfshire dhe sinjalistiken.
- f. Minimumi 1 (nje) inxhinier mekanik ose mekatronik
- g. Minimumi 3 (tre) teknike instalimesh te telekomunikacionit
- h. Minimumi 5 (pese) persona te certifikuar nga per instalimin e produkteve dhe mirembajtjen e tyre.
- i. Minimumi 1 (nje) Saldator per punimet e saldimit te planifikuara te shtyllave. |

- j. Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNA ose ekuivalente.
- k. Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNA Security ose ekuivalente.
- l. Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNP Enterprise ose ekuivalente.
- m. Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNA Routing & Sëitching ose ekuivalente.

të cilët të figurojnë me këtë kategori profesioni në listëpagesat e shoqërisë, si dhe të paraqiten:

- Kontrata Individuale pune (të vlefshme)
- Diploma e arsimit të lartë
- Listëpagesa e deklaruar dhe e miratuar ne institucionet tatimore per 3 muajt e fundit.
- Certifikatat perkatese sipas kerkese te vlefshme

Kriteri 2.3.8 do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST dhe bazuar ne përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.9 Duke patur parasysh instalimet e nevojshme dhe punimet civile qe duhen kryer per to me cilesi dhe ne kohe per kete procedure, Operatori ekonomik duhet te disponoje licensat profesionale sipas punimeve te parashikuara per realizimin e kesaj procedure si me poshte:

1. NP-1 Punime Germimi ne Toke
2. NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
3. NS-14 Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV, etj
4. Autorizim nga Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare per Shtrimet e Rrjeteve Fiber Optike dhe Ofrimin e Sherbime te Komunikimeve Elektronike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8 janë të gershetuara me njera tjetren dhe vijne bazuar ne në nenin 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Nga autoriteti kontraktor, ne baze te marreveshjeve te bashkepunimit, eshte vendosur qe artikujt objekt te kesaj procedure prokurimi te iplementohen me sistemin aktual qe disponon Bashkia Kamez dhe te Drejtorise Vendore te Policise Kamez, ne kuader te rritjes te sigurise në territorin e saj nëpërmjet metodave të avancuara të raportimit dhe monitorimit të përshtatshem, duke siguruar funksionimin efektiv të bizneseve të kësaj bashkie dhe siguri maksimale për qytetarët e vet. Bazuar në nevojat e punës dhe takimet midis specialistëve të Bashkisë dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Kamez, janë përcaktuar pajisjet që janë të nevojshme të prokurohen, janë hartuar specifikimet teknike dhe preventivi me artikujt perkates. Vendorsja e ketyre kriterëve te kualifikimit, eshte pjese e domosdoshme ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, pasi pajisjet do te montohen, implementohen ne sistemet ekzistuese, do te provohen nese i kryejne funksionet sipas specifikimeve teknike, do te instalohen aplikacionet apo softëeret perkatese etj. Kjo e ben te domosdoshem qe operatori ekonomik te jape nje garanci nje vjecare per pajisjet, por pervec sa me lart, me specialistet qe disponon do te ofroje trajnimet e nevojshme. Kerkesat dhe specializimet e stafit qe kerkohen jane te lidhura ngushte me natyren e kontrates qe prokurohet.

**2.3.10 Produktet duhet te jene te pajisura me certifikate konformiteti (CE), sipas standarteve te miratuara si dhe nuk duhet te kene ndalim perdorimi neper Institucionet Shteterore ne asnje nga vendet partnere te Republikes se Shqiperise.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ne rast se pajisjet janë të pajisura me certifikate konformiteti (CE), sipas standarteve të miratuara, kjo është një garanci për cilësinë e tyre që tregon se janë të testuara nga institucionet e autorizuar, përpara hedhjes së tyre në treg. Gjithashtu standartizimi i Produkteve të sigurisë me vendet partnere të Republikës së Shqipërisë dhe homologet e Policisë së Shtetit në vendet BE dhe USA është kusht për të siguruar cilësinë dhe garancinë e nevojshme të punës.

Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimum mjetet e mëposhtme :**

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtes nga 5 deri ne 12 ton dhe vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
2	Kamionçine (me kapacitet mbajtes nga 0.5 deri 3 ton)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
3	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
4	Mjete transporti stafi 4+1	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	3

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkëpunimi.



## PREVENTIVI PRODUKTEVE DHE SHERBIMEVE

NR	PERSHKRIMI	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	F.V. Pusete plastike 30x30x30, kapak te forte	cope	35		
2	F.V. Percjelles PPV, Ø (3G X 10mm2)	ml	1400		
3	F.V. Percjelles PPV, Ø (3G X 6mm2)	ml	3700		
4	F.V. Percjelles PPV, Ø (3G X 4mm2)	ml	2280		
5	F.V. Kabell netëork (S/FTP Cat.6e) me aksesore	ml	4100		
6	F.V. Tub i forte fleksibel Ø 63 mm	ml	18900		
7	F V. Shtylla metalike H=8 ml d=160 mm	cope	25		
8	F.V. Elektroda tokezimi te zinguara 50x3mm	cope	25		
9	F.V. PDU 6 Port (Te paisur me mbrojtje)	cope	27		
10	F.V. Rack 36U 800x800 i kompletuar me ventilim	cope	1		
11	F.V. Sëitch Qendror Fiber 16 Port SFP + 8Port GB	Cope	2		
12	F.V. Kabinet outdoor i kompletuar me burim energjie	cope	25		
13	F.V. Bateri per Rack Outdoor 50AH	Cope	25		
14	F.V. Sëitch Rrjeti UPS 8 Port PoE	Cope	25		
15	F.V. UPS Qendror 10KVA perfshire baterite	Cope	1		
16	F.V. NVR 64 Kanale perfshire HDD 40TB	Cope	2		
17	F.V. Kamera IP Bullet	Cope	60		
18	F.V. Kamera IP Bullet per Lexim Targa dhe Survejim	Cope	6		
19	F.V. Kamera IP Bullet per Lexim Targa	Cope	39		
20	F.V. Suporte per instalim Kamerash ne Shtylle	Cope	105		
21	F.V. Ëorkstation Qendror per menaxhim	Cope	1		
22	F.V. Softëare Menaxhimi Kamera	Cope	1		
23	F.V. Led Ëall 4 Ekrane i Kompletuar	Cope	1		
24	Sherbim Data per cdo Pike (12 Muaj)	Cope	25		
25	Sherbim Data per Sallen e Monitorimit (12 Muaj)	Cope	1		
	<b>SHUMA</b>				
	<b>TVSH</b>				
	<b>CMIMI TOTAL (BRUTO)</b>				

Punimet civile te nevojshme per shtrimin e ketij rrjeti si germime, shtrime dhe rikthim ne gjendjen fillestare te rruges ose trotuarit duhet te kryhen nga OE dhe jane pjese e pergjegjesise se tij per mirembajtje. Sherbimi qe do te ofroje OE per lidhjen e ketyre pikave me sallen e monitorimit duhet te jete totalisht i pavaruar si nga infrastruktura kabllore ashtu dhe nga pajisjet lidhese nga cdo lloj sherbimi tjeter dhe kualiteti i ketij sherbimi duhet te garantohet nga OE per gjate gjithe kohes se kontrates se sherbimit.